



Duke u mbështetur në nenin 41 dhe 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 42 dhe 49, të Statutit të Komunës dhe nenit 7 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bënë këtë:

### NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës, që të marrin pjesë në seancën e II-të, të punës për vitin 2014, që do të mbahet më 28.02.2014, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në orën 10:00.

Kërkohet nga anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë në seancë, ndërsa në rast të mungesës eventuale, mungesa duhet të arsyetohet me shkrim para mbajtjes së mbledhjes.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Lidhur me këtë seancë propozohet ky:

### REND IDITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Njoftimi i Kryetarit me emërimin e Nënkyetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale,
4. Dhënia e betimit të dy anëtarëve të rinj të Kuvendit të Komunës (nëse KQZ -ja bën njoftimin me emra, zëvendësimi i dy anëtarëve të KK; Ramiz Rustës -PDK dhe Bedri Gashit -AAK),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF-së,
6. Shqyrtimi dhe themelimi i komiteteve të tjera të Kuvendit,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës (neni 2 i Rreg. QRK, nr.23/2013),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim -vendimit për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim (neni 3 i Rreg. QRK 23/2013),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartje të mjeteve të pashpenzuara nga viti 2013 në vitin 2014 (nga Drejtoria e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim),
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit të Planit të Punës së Kuvendit dhe caktimin e Kalendarit vjetor të punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit për vitin 2014,

11. Plotësimet, me zëvendësim të anëtarëve të rinj për vendet e lira në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe shefat e Grupeve të anëtarëve:  
a. Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për zëvendësim të anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa 1 (një) nga subjekti i PDK-së dhe,  
b. Ndryshimi dhe plotësimi për zëvendësim të shefit të Grupit të anëtarëve nga subjekti i PDK-së dhe AAK-së,  
12. Të ndryshme.

01 Nr.06- 755 /14  
Klinë, më 13. 02 2014.



KRYESUESI,  
Dr. Haxhi Ibishi



KOMUNA E KLINËS  
KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 07-590/14

KLINË, 10.1.2014

PROCESVERBAL

I SEANCËS SË PARË TË RREGULLT TË PUNËS, MBAJTUR, MË 10.1.2014, NË  
ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, nënkryetari i Komunës, Gjokë Lleshaj, anëtarët e KK (27), drejtorët e Ekzekutivit, përfaq. të KFOR-it, përfaq. të OSBE-së, përfaq. të Policisë së Kosovës në Klinë, OJQ-të, mediet, qytetarët etj.

Mbledhjen e hapi Pjetër Coli, në cilësinë e anëtarit më të vjetër të KK. Kryesuesi i seancës Coli, fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të Kuvendit të Komunës, të parën për vitin 2014. Kryesuesi i seancës Coli, uroi suksese këtij legjislativi për këtë mandat.

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Dhënia e betimit të anëtarës të KK-Shukrije Shalës (AAK-LDD),
4. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
5. Themelimi i Komiteteve obliguese:
  - Komiteti për Politikë dhe Financa,
  - Komiteti për Komunitete,
6. Shqyrtimi i çështjes së dhënies së tokës komunale në shfrytëzim dhe ndërmarrja e veprimeve përkatëse ligjore (anulimi i vendimit të KK-nr. 01-11-464-585/11 e miratuar me dt. 29.07.2011, miratimi i vendimit për vlerësimin e ofertave dhe propozimi e listës së ngushtë KK për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim, nr. 01-464-1971/2011, i miratuar më dt. 24.06.2011, marrja e vendimit për publikimin e konkursit publik për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale),
7. Të ndryshme.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Pjetër Coli, konfirmoi që nuk ka mungesa të anëtarëve të KK.

**Skënder Merturi**, meqenëse nuk ishte në rend të ditës, lexoi në shkresë drejtuar Kryetarit të Komunës së Klinës, z. Sokol Bashota. (Diskutimi i tij është pjesë integrale e video-incizimit).

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

**Prend Buzhala dhe Avni Gashi**, patën vërejtje procesverbalit. Diskutimi i tyre ishte komplet jashtë rendit të ditës, për të cilën edhe Kryesuesi i seancës, në vijimësi, sikur në rastin e anëtarit parafolës, kërkoi që këto deklarime të mos përfshihen në procesverbal. (Diskutimet janë pjesë integrale e video-incizimit).

**Pjetër Coli**, tha të mos praktikohet që të dilet jashtë rendit të ditës. "Askujt nuk i merret e drejta e fjalës", pohoi kryesuesi i seancës Coli, i cili në vijim pasi i lexoi pikat e rendit të ditës, po ashtu sqaroi që pika e 6 e rendit të ditës ka pësuar ndryshime dhe propozoi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës. "Nuk e di nëse këtë pikë jemi në gjendje sot që ta shqyrtojmë dhe të sjellim një vendim". Kryesuesi i seancës, Pjetër Coli e vuri në miratim pikat e rendit të ditës.

**Pas këtyre diskutimeve Kryesuesi i seancës vuri në miratim rendin e ditës të lartshënuar, i cili me vota unanime u miratua po ky rend i ditës.**

**Ali Shala**, zyrtar ligjor, sqaroi çështjen e pikës së 6 të rendit të ditës dhe kërkoi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

**Pjetër Coli**, tha se unë paralajmërova se a jemi në gjendje sot të marrim vendim, derisa nuk dihet edhe çështja e ekzekutivit, për ta shqyrtuar dhe prurë vendim lidhur me këtë pikë. "Kjo pikë, shtoi kryesuesi Coli, edhe ashtu ka pësuar ndryshime në formulimin e saj. Unë ia kisha propozuar Kuvendit edhe Kryetarit që pikën e 6 për ta shtyrë për një seancë tjetër, sepse, edhe kemi anëtarë të rinj të Kuvendit të cilët nuk janë në rrjedha akoma, edhe çështja e ekzekutivit nuk dihet, që domethënë për këtë pikë kërkohet parapërgatitje e mirë për të prurë vendim", tha ai.

**Sokol Bashota**, tha se i përshëndeti të pranishmit. "Uroj anëtarët për punë të mbarë. Më vjen mirë që kemi arritur mirëkuptimin për të ofruar mundësi ligjore që brenda afatit për të kryer obligimin si betim. Vendimi për vendosjen e atyre 7 shtëpive të të kthyerve të komunitetit RAE, AK ka marrë një vendim më herët, e ka përcaktuar edhe pronën, realisht ka qenë mjaft e kontestuar edhe prej qytetarëve duke sjellë edhe një peticion edhe në Komunë edhe në Asamble, por që është e domosdoshme për ta caktuar një lokacion për ata dhe ne duhet për të marrë një vendim, më së pari për ta shfuqizuar vendimin e mëhershëm, që ka marrë kjo AK, në mënyrë për ta ofruar mundësinë tjetër, ku ekzekutivi e ka përcaktuar lokacionin, që është në harmoni me të gjitha normat dhe është gjetur vendi, meqenëse, pastaj duhet të merret pjesa e ekzekutivit. Nëse e shihni të rrugës që ta shfuqizojmë atë vendimin e mëparshëm për ndarjen e lokacionit në pjesën e Dresnikut, pastaj për t'u përcaktuar për lokacionin tjetër për të proceduar më tutje", shtoi kryetari Bashota.

**Pjetër Coli**, tha se domethënë sot vetëm për ta shfuqizuar vendimin e mëhershëm që ka marrë Kuvendi i Komunës, përkatësisht legjislacioni i kaluar.

**Fadil Gashi**: "Uroj sukses Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës. Po shihet që nuk ka përgatitje serioze për seancë, që ka qenë hapësirë e mjaftueshme që organet e pushtetit lokal që ta përgatitin këtë seancë. E para, fillon me vonësë, e dyta ne veç kemi kaluar pikën e dytë të rendit

të ditës, tash diskutohet komplet rendi i ditës. Dhe, mendoj që keni pasur hapësirë të mjaftueshme edhe ju si Kryesues që të fitoni përvojën e një udhëheqje të seancës, aq më tepër që ke pasur praktikë që ke udhëhequr, por ta kanë imponuar të tjerët dhe sigurisht emocionet e bëjnë të veten. Por tash jemi në vazhdim të pikave të rendit të ditës, herë thua a jeni për të hequr prej rendit të ditës, herë a jeni për ta lënë gjysmën e rendit të ditës të asaj pike, prandaj nuk po dimë a duhet në tërësi për ta lënë atë pikë, apo a duhet vetëm atë pjesë për ta shfuqizuar, veç vendimin e parë dhe për ta lënë pjesën tjetër për seancën e radhës, që unë mendoj që asnjëra as tjetra nuk kanë nevojë për t'u hequr, sepse sot e shfuqizon atë edhe është procedurë krejt normale që këtë pjesë të ekzekutivit e merr Kuvendi për dhënie në shfrytëzim dhe nuk ka nevojë fare ekzekutivi për të pasur pritje për këtë çështje, nëse veç është identifikuar lokacioni. Dhe, vazhdoi anëtari Gashi, nuk pajtohem me pjesën e parë që ju drejtuat dy parafolësve, që ata kanë të drejtë për ta shprehur opinionin e tyre për cilëndo çështje, sepse nuk iu dhatë hapësirë në fillim, posa patët filluar seancën dhe e keni filluar pa pyetur asnjërin prej anëtarëve se a ka ndokush për rend të ditës. Ka qenë një praktikë e kaluar, duhet të vazhdohet në këtë mënyrë dhe ato që ju i përgatitni për seancë, që mendoj që e keni një shërbim të mirë, i cili ka tentuar gjithmonë për të qenë në nivel të përgjegjësive për gjithë anëtarët e Kuvendit, nuk është mirë që tash tërësisht Kuvendin për ta çuar në lajthitje dhe të krijohet përshtypja nga anëtarët e rinj të Kuvendit që kështu tollovi ka qenë edhe në të kaluarën, por nuk ka qenë kështu, por kështu e bëjnë njerëzit udhëheqja që tash është që nuk është e papërvojë, por i kanë ato problemet e brendshme dhe tash ne jemi viktimë”, shtoi anëtari Gashi.

**Pjetër Coli**, u pajtua me vërejtjet e bëra nga anëtari Gashi, mirëpo lëshimet e tij i arsyetoi me mungues të eksperiencës. “Mendoj se ky diskutim yti është paksa i tepruar, sepse ne nuk mund të kërkojmë prej fëmijës se si të jetë në jetën e tij. Është seanca e parë, unë personalisht nuk jam ndonjë udhëheqës profesionist, ose me eksperiencë që ke pasur ti, që e ke udhëhequr gjithherë mirë, prandaj seanca udhëhiqet me përvojën, kapacitetin, me eksperiencën që ka kryesuesi për të cilin duhet për të pasur tolerancë edhe për lëshimet e tij. Ne njerëz jemi, shokë jemi, një detyrë kemi, konsideroj që asgjë nuk ndodhi këtu që tash për ta alarmuar këtu, se për t'u marrë me probleme të brendshme as të jashtme mua nuk më ka imponuar askush, por me të gjitha janë të miat, të mos hyjmë në ato punë. Tjetra, shtoi në vazhdim kryesuesi Coli, ka ndodhur edhe herën tjetër kur kemi diskutuar, të kam kërkuar ndihmën duke u bazuar në eksperiencën tënde dhe konsideroj që kjo është njerëzore. Prandaj, unë mendoj që kam plotësisht të drejtë për ato që ju thashë dy diskutuesve. Është lëshim imi që nuk e kam qitur me kohë nuk e kam qitur komplet në aprovim. Ajo u kompensua, prandaj unë mendoj anëtarët që marrin rendin e ditës dhe kanë për të thënë diçka jashtë rendit të propozuar të ditës, dihet se procedura çfarë është. Nuk është gabim imi, por i atyre që nuk ju kanë drejtuar shërbimit se kanë për të diskutuar diçka tjetër”, pohoi kryesuesi i seancës, z. Coli.

**Fadil Gashi**, tha se pikën e 6 nuk keni arsye ta shtyjeni, sepse e aprovuar është. “Pse të hiqet? Është aprovuar si pikë e rendit të ditës”, shtoi Gashi.

**Pika e tretë: Dhënia e betimit të anëtares të KK-Shukrije Shalës (AAK-LDD).**

Anëtarja nga radhët e AAK-LDD, znj. Shukrije Gashi dhe betimin solemn dhe nënshkroi Deklaratën.

**Pika e katërt: Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.**

**Pjetër Coli**, sqaroi procedurat ligjore për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Ai kërkoj që të zgjidhet një komision prej 3 ose 5 anëtarëve. Coli kërkoj për përcaktim të çelësit.

U vendos që çelësi i Komisionit të jetë 3 anëtarë.

U procedua me propozime të anëtarëve të Komisionit.

**Ramiza Rrusta**, propozoi **Rasim Millakun**

**Ndue Shabanaj**, propozoi **Violetë Zefin**

**Ramiz Rrusta**, propozoi **Qamile Qitakun**

**U vu në miratim Komisioni në përbërje**

1. **Rasim Millaku**
2. **Violetë Zefi**
3. **Qamile Qitaku.**

**Me shumicë të votave, 1 kundër u miratua përbërja e këtij komisioni për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.**

Kryesuesi i seancës, z. Coli sqaroi punët dhe detyrat e komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit të KK. Coli sqaroi që votimi duhet të bëhet me vota të fshehta. “Komisioni është për mbarëvajtjen e procesit të votimit”.

Në vijim, Coli sqaroi procedurat e zgjedhjes së Kryesuesit të KK.

U procedua me propozime të kandidatëve për Kryesues të KK.

**Elvira Sejdiu**, për kryesues të KK e propozoi dr. **Haxhi Ibishin**. Anëtarja Sejdiu arsyetoi propozimi.

**Prend Buzhala**, propozoi znj. **Violeta Zefin**, nga radhët e Iniciativës për Progresin e Klinës. Buzhala arsyetoi propozimin.

**Ramz Rrusta**, theksoi se nuk jemi ne këtu të instaluar po jemi të zgjedhur me votën e popullit, përkatësisht me votën e atyre që na kanë votuar. “Ndërsa, tjetra është, që në emër Grupit të anëtarëve të PDK-së si kryetar i këtij grupi e mbështesim kandidaturën e dr. Haxhi Ibishit për Kryesues të Asamblesë Komunale në Klinë.

**Ndue Shabanaj**, theksoi që ndoshta nuk ka nevojë ta mbështesim kështu deklarativisht të propozuarin zotëri Haxhi Ibishin për Kryesues të AK, megjithatë meqë u propozua nga z. Prend Buzhala Violeta Zefi, që i takon Iniciativës për Progresin e Klinës. “Ne si Grup i anëtarëve që i takojmë këtij subjekti politik, me marrëveshje e kemi mbështetjen për zotëri Haxhi Ibishin. Prandaj, mund të propozohet edhe dikush tjetër, unë nuk jam për ta injoruar këtë qasjen që paraqiti z. Prend Buzhala këtu, aspektin gjinor të përfaqësimit, jo unë, por askush tjetër dhe realisht askujt nuk jam për t’ia mohuar të drejtën jashtë këtij qëndrimi tonë të përbashkët për të pranuar kandidaturën, por unë po e them qëndrimin që kemi që realisht më duhet ta sqaroj këtu”, shtoi anëtari Shabanaj.

**Fadil Gashi**, theksoi se e kuptoj që marrëveshja është për dr. Haxhi Ibishin, por derisa nuk e kemi deklaratën personale të anëtares së Kuvendit që është e propozuar, duhet për ta tërhequr nga Komisioni. "Po qe se ajo do për të qëndruar kandidate për kryesuese, të cilën me këtë rast e kisha mbështetur, duhet tërhequr nga komisioni. Tjetër, askush nuk mundet në emër të anëtarit për ta tërhequr ose për ta vënë. Realisht, dy propozime i kemi dhe shkojmë me dy propozime derisa nuk tërhiqet njëri prej tyre", shtoi anëtari Gashi.

**Ndue Shabanaj**, theksoi që së pari duhet të vendoset se ajo të vendos a ka pranuar kandidaturën apo jo, kjo bëhet edhe me deklarin e saj personal, por edhe me aprovimin tonë. "Nëse ajo pranon kandidaturën, natyrisht, që duhet të tërhiqet nga Komisioni, nëse jo, atëherë nuk ka nevojë që të tërhiqet nga ky komision dhe nuk ka nevojë të bëhet ndryshim në komision", pohoi prof. Shabanaj.

**Violetë Zefi**, falënderoi z. Buzhala për propozimin. "Ndjehem shumë e privilegjuar që ky propozim vjen nga zotëri Prend Buzhala, po ashtu njëherësh i falënderoj edhe gjithë ata të tjerët që shprehen gatishmërinë për të më mbështetur kandidaturën time. Mirëpo, për shkak të rrethanave të caktuara dhe për shkak të shumë përgjegjësi të tjera që i kam, më vjen keq, por nuk mund ta pranoj një kandidaturë të tillë", pohoi anëtarja Zefi.

**Prend Buzhala**, tha se kërkoj falje që të kanë bërë presion për të mos pranuar.

**Ndue Shabanaj**, tha që mua më vjen keq që në fillim, është seanca e dytë që ne nuk e kemi zgjedhur Kryesuesin e AK, ndërsa ne lëshohemi në këso akuza, në kritika, në mbrojtje, e ku ta dimë çfarë. "Unë mendoj se kanë marrë fund disa çështje lidhur me fushatën, kanë përfunduar ato, nuk është dashur për të na përcjellë një situatë e tillë në këtë AK. Secili prej nesh përfaqësojmë diçka këtu dhe secili subjekt politik i ka qëndrimet e veta dhe realisht nuk ka arsye më së paku Prend Buzhala të thotë që dikush i bën presion dikujt. Dëshiroj për të mos u marrë me këto çështje në asamble", shtoi prof. Shabanaj.

**Prend Buzhala**, nuk e di për çfarë akuzash e ka fjalën që mund të më drejtojë.

**Pjetër Coli**, tha se jemi tubuar për t'i kryer këtu disa detyra që janë para nesh, për të tjerat ka kohë. "Domethënë, shtoi Coli, i vetmi kandidat është dr. Haxhi Ibishi. Lus shërbimin që të përgatis çështjet teknike për të proceduar për votim. Është një kënd i improvizuar ku do të votojmë. Komisioni do të vazhdojë me punën e vet", shtoi ai.

**U mor vendim për një pauzë prej 15 minuta.**

Pas pauzës u procedua me vazhdimin e seancës.

Kryesuesi i seancës, z. Coli sqaroi që në seancë janë 27 anëtarë. Lus komisionin që të fillojë me punë.

**Fadil Gashi**: "Pa hyrë në votim, dëshiroj të bëj publik qëndrimin e opozitës, atë që ne e kemi thënë prej përfundimit të zgjedhjeve. Do të jemi opozitë konstruktive, do të jemi në shërbim të qytetarëve për atë sa neve na kanë votuar dhe për atë sa ne përfaqësojmë me gjithë kapacitetet tona që i kemi, gjithmonë në këtë sallë, për të gjitha çështjet që prekin interesat e qytetarëve të komunës së Klinës. Po ashtu, do të jem pjesë e atyre 11 mijë votuesve që nuk janë pajtuar në raundin e dytë me konceptin tuaj, përkatësisht koalicionit tuaj, prandaj ne do t'i bashkohem atij

koncepti, do të jemi bashkë me opinionin e atyre 11 mijë votuesve, që unë nuk i quaj sikur Kryetari, "ka ndodhur e keqe, njollë e zezë", por thjesht nuk janë pajtuar me atë koncept dhe nuk e kanë votuar në raundin e dytë këtë koalicion. Prandaj, pohoi në vijim Gashi, ne dëshirojmë për t'ju liruar në përzgjedhjen e juaj, në ndërtimin e ekzekutivit tuaj, duke përfshirë edhe Kryesuesin, me gjithë respektin që kemi për anëtarët e Kuvendit, për Kuvendin në përgjithësi, ne do ta lëshojmë këtë seancë dhe do të jemi aktivë prej seancës së radhës për të gjitha çështjet që ngritën në këtë sallë. Edhe një herë e përsëris, nuk do të jemi pjesë e këtij koalicioni dhe ne ju dëshirojmë sukses koalicionit për aq sa do të mund të jetësojë ato që ju keni premtuar", konstatoi Gashi. (Grupi i anëtarëve të LDK-së lëshoi sallën e Kuvendit).

**Bedri Gashi**, tha se meqë unë e thashë që përfaqësoj Grupin e anëtarëve të AAK, desha t'ju njoftoj për qëndrimin e AAK-së. "Ne do të abstenojmë në votimin për Kryesuesin e Kuvendit, jo se jemi kundër apo pro tij, por deri në një vendim tjetër që do ta marrim ne, do të abstenojmë. Do të qëndrojmë në sallë, nuk do të marrim pjesë në votim, kështu që ky është qëndrimi ynë", theksoi anëtari Gashi.

**Prend Buzhala**, tha se qëllimi im që të ketë një kandidat tjetër ka qenë shumë i sinqertë, që këtë pjesë këtu ta nxjerrim prej një krize që veç e ka kapluar. "Dhe, vazhdoi Buzhala, kërkesa që unë të jem, si të thuash njëfarë mbështetësi, ka qenë pikërisht prej Iniciativës për Progresin e Klinës, ata kanë dërguar njerëz te unë. Unë ju kam premtuar që po do të mbështes kandidaturën e kandidatit të tyre. Po, këtu, thatë një qëndrim tepër demagogjik- jo-në! E dyta, mirë është që tash e tutje të mos bëhen shantazhe në drejtim të njerëzve duke i nxitur nëpërmes konkurseve të punësimit. Është një ushtar i UÇK-së që ka ardhur direkt te unë, demokristian i përjashtuar dhunshëm nga puna këtu pasluftës, i cili është kushtëzuar, që nëse dëshiron të hyjë në punë ai duhet të bëjë presion te përfaqësuesi i demokristianëve që ta ngris dorën që të votojë për përfaqësuesin që e propozon. Prandaj, unë detyrohem që ta braktisë këtë seancë jodemokratike" shtoi Buzhala. (Përfaqësuesi i PSHDK-së, z. Prend Buzhala lëshoi seancën e Kuvendit).

**Pjetër Coli**, tha se duhet të thuhet personi me emër dhe mbiemër. "Ne të patën edhe një çështje të drejtpërdrejtë se ai sot është dashur të deklarohet para AK që a dëshiron për të qenë anëtar i AK, apo dëshiron për të vazhduar me punën si shërbyes civil, meqë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk ia mundëson funksionin në dyfishtë", theksoi Coli.

**Sokol Bashota**, theksoi se desha për të folur sa ata ishin këtu, mirëpo ashtu qysh e kanë lënë qytetarin pasdore edhe qytetari i ka qitur këta jashtë salle. "Kjo është pak shqetësuese, se dalja e tyre jashtë tregon se ata kanë krizë, ata kanë probleme, sepse nuk i besojnë njërit – tjetrit për votën karshi kandidaturës. Kështu që, përgëzoj qëndrimin e AAK-së të cilët u gjenden në sallë dhe janë në shërbim të qytetarëve, por braktisja e sallës realisht e dëshmon joseriozitetin e tyre karshi besimit edhe për aq sa kanë besim dhe tregon krizën që kanë tek të vetët, përkatësisht anëtarësia. Prandaj, është mirë të procedohet me punën sipas rendit të ditës. Njoftoj Kuvendin se Ramiz Rusta dhe Rasim Millaku janë asamblastë, e kanë bërë betimin, kështu që Drejtoria e Financave le të procedojë me ato anët teknike, ndërsa ata që janë shërbyes civilë sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nuk ju lejohet që të mbajnë dy pozicione. Kështu që, unë si Kryetar i Komunës do të kërkoj me shkresë pozicionimin e tyre për njërin vend, kjo i mbetët punës së ekzekutivit" nënvizoi kryetari Bashota.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se për hir të informimit të drejtë, ju informoj që askush nga subjekti politik që përfaqësoj nuk ka kërkuar për mbështetjen e kandidaturës për anëtarin e lartcekur .

“Edhe po që se ka ekzistuar një kërkesë e tillë, ajo kërkesë ka qenë tërësisht individuale, por jo me qëndrimin e subjektit tonë politik”, shtoi prof. Shabanaj.

**Pjetër Coli**, tha se lus komisionin të procedojë me punën.

**Rasmin Millaku** (kryetar i Komisionit), bëri transparente gjendjen e kutisë votuese. Në vazhdim Millaku ftoi asamblistët për votim.

U procedua me votimin për Kryesues të Kuvendit.

**Rasim Millaku**, konfirmoi se në votim kanë marrë pjesë 14 anëtarë, 9 fletëvotime janë pro dr. Haxhi Ibishit, ndërsa 5 fletëvotime të pavlefshme.

**Ramiz Rrusta**, në emër të GP të PDK-së kërkoi pauzë në kohëzgjatje prej një ore.

**U miratua propozimi i anëtarit Ramiz Rrusta.**

Pas pauzës prej një ore u procedua me seancë.

**Pjetër Coli**, konfirmoi që në seancë prezantojnë 19 anëtarë. Coli konfirmoi edhe një herë rezultatin e votimit të raundit të parë: 9 vota pro dr. Haxhi Ibishit, 5 fletëvotime të pavlefshme. Coli kërkoi të procedohet me votimin e raundit të dytë.

**Bedri Gashi**, tha se pas ofertës që GP i AAK-së kanë marrë nga kryetari, mbështesim kandidaturën e dr. Haxhi Ibishit për Kryesues të Kuvendit.

U procedua me raundin e dytë për zgjedhjen e Kryesuesit të KK.

**Sokol Bashota**, theksoi se proceset demokratike që ndodhën sot në Kuvendin e Klinës determinojnë këto iniciativa dhe përkushtime. “Dihet mirëfilli, se këto procese nganjëherë janë të dhembshme, mirëpo PDK edhe në të kaluarën edhe sot dëshmoi se gjithherë është në funksion të interesit të qytetarëve në radhë të parë. Ne si parti politike, edhe në të kaluarën, më 2007 dhe 2009, kemi pranuar për aleatë subjektet tjera politike, që ka qenë shumë e dhembshme, por le të kuptohet se është në interes të qytetarëve. Ne jemi përballur, i kemi pasur kundërshtarë potencialë AAK-në për Komunën e Klinës, po ashtu edhe LDK-në, mirëpo për ne nuk ka vija të kuqe për bashkëqeverisje dhe gjithmonë do t’u bëjmë thirrje asamblistëve të hiqen nga ai petku i subjekteve politike strikt kur është në pyetje interesi i qytetarëve. Sot, vazhdoi kryetari Bashota, duke e parë një udhëheqje, e pranoi me modesti Kryesuesi i seancës, se nuk ka përvojë në këtë çështje, në këtë punë, pas zgjedhjes së Kryesuesit, konsideroj se do ta marrë votën kësaj radhe. do t’i kërkoj që të mos lejojë të tilla fyerje që i bëjnë njëri-tjetrit, për arsye se këtu pastaj mund të ketë edhe konotacione të tjera. Askush askujt nuk i bën presion për të dhënë betimin. Unë kam të drejtë asamblistit tim për t’i thënë “respekto vendimin e partisë!” Mirëpo, nuk kam të drejtë as anëtarin e partisë sime ta kushtëzoh me votë ndaj kujtdo qoftë këtu për ndonjë post. Çdo detyrë në Komunën e Klinës i nënshtrohen konkursit dhe vetëm njerëz me kualitete konform konkursit do të zgjidhen gjithmonë. Kurrë askush nuk është punësuar si rezultat i shantazheve dhe rezultat i klanëve. Kështu që, ne në parim e kemi marrë mbështetjen bashkë me dy Iniciativat dhe AAK-në karshi kandidaturës së përbashkët për dr. Haxhi Ibishit për Kryesues të KK dhe uroj që ky proces të shkojë sa më mirë”, theksoi ndër të tjera kryetari Bashota.

U procedua me raundin e dytë për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.

Rasim Millaku, theksoi se prej 19 pranishmëve të gjithë kanë votuar.

Komisioni konstaton që prej 19 votuesve, për Kryesues të KK, dr. Haxhi Ibishi ka marrë 19 vota.

Pjetër Coli, konfirmon se me 19 vota pro, dr. Haxhi Ibishit zgjidhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Haxhi Ibishi, vazhdoi me udhëheqje të seancës së Kuvendit.

Haxhi Ibishi, u prezantua me një fjalë përshëndetëse. "Ju përgëzoj për gatishmërinë dhe kondicionin që ke treguar në këtë maratonë të zgjedhjes së kryesuesit të AK. I nderuari Kryetar i Komunës, njëherësh edhe kryetar i PDK-së, dhe i nderuar kandidat i përbashkët i listës së dy Iniciativave, ju përgëzoj për zgjedhjen tuaj si kryetar i Klinës dhe ju uroj punë shëndet dhe mirëqenien tuaj personale dhe të familjes. Faleminderit kolegë nga opozita e deridjeshme, bashkudhëtarë të proceseve të ndryshme që kemi zhvilluar për Klinën dhe Ju të pranishëm. Një falënderim i veçantë shkon për Iniciativën e Progresit për Klinën, për PDK-në dhe për IQK, e cila ma mundësoi mua të jem këtu para jush si kandidat për Kryesues të Kuvendit dhe tash i zgjedhur. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë bashkëpunëtorët e mi, në rrugëtimin tonë të përbashkët, për familjen time e cila jo pak pati sfida në këto dy vitet e mia në angazhimet e mia politike. Do t'ju garantoj juve këshilltarët të AK dhe Ju i nderuari Kryetar i Komunës që do të jem me përkushtimin në angazhimin që më takon mua si Kryesues i AK. Do të angazhohem dhe do të respektoj Rregulloren e punës së Kuvendit, ligjet në fuqi dhe do të angazhohem për një debat të gjerë dhe përmbajtësor me të vetmin qëllim që vendimarrja të jetë sa më gjithëpërfshirëse. Falënderoj edhe kolegët që lëshuan seancën, për arsye se edhe ata janë pjesë e një koloriti të përbashkët të demokracisë së Klinës. Me bindje them, votimi në raundin e parë dëshmoi që ky koalicion i krijuar përpara tash i mbështetur edhe nga AAK nuk ka pasur presion, nuk ka pasur askush presion për dy fakte: fakti i parë, votat nuk erdhën sikur të ishin vota të një regjimi ushtarak, por erdhën thjeshtë vota demokratike me bindjen e plotë të secilit prej jush që unë e vlerësoj, dhe, e dyta: Në fund kisha dashur unë të ushtroj një ndikim familjar te dikush në opozitë, të jeni të bindur që kam një njeri ose dy më shumë njerëz që më lidhin edhe familjarisht me ta që ma kanë dhënë edhe sot votën por nuk kam biseduar kurrë me ta për të ma dhënë votën mua ose koalicionin pa një marrëveshje paraprake. Shpresoj që do të ecim bashkë dhe ky rrugëtim yni do të jetë i suksesshëm", nënvizoi në fjalën e tij përshëndetëse kryesuesi Ibishi.

Sokol Bashota, përshëndeti zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit. "Më lejoni, që si Kryetar i Komunës dhe i PDK-së, të uroj zgjedhjen e dr. Haxhi Ibishit për kryesues të Asamblesë Komunale. Më lejoni që t'i falënderoj të gjithë atë të cilët i dolën besnikë një premtimi që dhanë duke votuar kandidatin e përbashkët të AK dhe dr. Haxhi Ibishit i dëshiroj sukses në zgjedhjen e tij si Kryesues të AK, duke i premtuar se do të ketë bashkëpunimin tim personal si kryetar i Komunës dhe gjithçka çka është në shërbim të qytetarëve dhe do të mundohemi që bashkërisht t'i respektojmë edhe ligjet që i vëmë para Asamblesë. Kështu që edhe një herë në emër tim personal dhe PDK-së, dr. Haxhi Ibishit i uroj suksese për zgjedhjen si Kryesues i Asamblesë", shtoi kryetari Bashota.

Bedri Gashi, tha se uroj dr. Haxhi Ibishit zgjedhjen për Kryesues të Kuvendit të Komunës. "Dr. Haxhi Ibishit, i uroj fat dhe shëndet, posaçërisht i uroj durim. Uroj të respektojmë ligjet dhe rregulloret të cilat janë në fuqi në mënyrë që t'i dërgojmë përpara proceset në mënyrë

institucionale që kemi. Ky urim vjen në emër të Grupit të asamblistëve të AAK-së. Urime, shëndet dhe suksese të gjithëmbarshe!”- theksoi anëtari Gashi.

**Ndue Shabanaj**, në emër të IPK-së i bashkohem urimit për dr. Haxhi Ibishin, shprehim kënaqësinë për këtë proces të rregullt zgjedhor që u krye këtu në AK, dhe dolëm nga punimet e kësaj asambleje, apo vazhdimi i këtyre punimeve me rezultatin e zgjedhjes së Kryesuesit. Ndoshta zhvillimet e më hershme hapën dilema se mund të mos jetë ky epilog i kësaj pike të rendit të ditës bash këtu si po e shohim dhe përjetojmë kënaqësinë për këtë. Dëshiroj të uroj Kryesuesin e ri të AK për zgjedhjen e tij në këtë post. Uroj që të kemi bashkëpunim të ngushtë pavarësisht se cilit subjekt politik i takojmë. Në këtu frymojmë në bazë të interesit të qytetarëve, votën e të cilëve e kemi marrë dhe atë duhet natyrisht ta përfaqësojmë në mënyrë të denjë. Ky momenti i fundit që është për t'u përshëndetur, mirëpo nuk e kemi pritur, që një GP, i cili u deklarua fillimisht, për pozicionin tjetër në fund e ndërroi këtë qëllim të cilin e përshëndes, por ndoshta kjo na imponoi në një formë edhe ne të tjerëve për ta shqyrtuar pozicionin tonë, por megjithatë ne nuk kemi asnjë hezitim edhe para votimit të parë, edhe pas votimit të parë, edhe pas këtyre ndryshimeve që rrjedhin, ne nuk ndryshojmë qëndrimet në atë kuptimin herë ta përkrahim, herë të mos e përkrahim. Natyrisht që e përkrahim, këto janë shprehje e interesave që i kanë subjektet politike për t'u përfaqësuar në pushtetin lokal në Klinë. Nuk ka asnjë keqkuptim në këtë drejtim, por edhe një herë dëshiroj për ta uruar Kryesuesin dhe i dëshiroj punë të mbarë dhe suksese në punimet e AK në Klinë”, nënvizoi në urimin e tij prof. Shabanaj.

**Pika e pestë: Themelimi i Komiteteve obliguese:**

- Komiteti për Politikë dhe Financa,
- Komiteti për Komunitete,

**Avni Gashi**, foli në emër të tri subjekteve politike që përfaqësojnë në Kuvend, AKR, PSHDK dhe “Vetëvendosje” dhe kërkoi që këto subjekte politike të përfaqësojnë Kuvend të jenë brenda një grupi të përbashkët të anëtarëve.

**U miratua propozimi, që AKR, PSHDK dhe Lëvizja VV ta përbëjnë një grup të anëtarëve.**

**Ndue Shabanaj**, propozoi që dy Iniciativat, IPK dhe IQK të formojnë një grup të anëtarëve.

**U miratua propozimi që IQK dhe IPK të kenë një grup të përbashkët të anëtarëve.**

**U procedua me themelimin e Komiteteve obliguese: Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete.**

Kryesuesi Ibishi, sqaroi që çelësi për KPF duhet të jetë: PDK 2 anëtarë, LDK 1 anëtar, GP i tri partive: AKR, PSHDK, VV 1 anëtar.

**U propozuan këta anëtarë:**

1. Ramush Agushi (PDK)
2. Ramiz Rrusta (PDK)
3. Pal Berisha (AAK)
4. Ndue Shabanaj (IPK-IQK)
5. Avni Gashi (AKR-PSHDK-VV)

**6. LDK – sjell emrin e anëtarit deri në seancën e radhës.**

U vu në miratim përbërja e anëtarëve të lartpropozuar për KPF

U miratua përbërja e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

U procedua me zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

**Qamile Qitaku**, sqaroi ecuritë dhe kriteret e përfaqësimit të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

**Sahit Balia**, sqaroi lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete. “T’i zbatojmë rregullat. Secili komunitet duhet të përfaqësojë. Komuniteti ashkali duhet të prezantojë në komitet, po ashtu edhe ai serb”, sqaroi Balia.

**Haxhi Ibishi**, theksoj që të përfaqësojnë të gjitha komunitetet. “Ne duhet të kemi 3 anëtarë: PDK- 1, AAK- 1 dhe LDK- 1”, sqaroi kryesuesi Ibishi.

U vu në miratim skema e delegimit për 3 anëtarë për Komitetin e Komuniteteve.

U miratua unanimisht skema e përfaqësimit të anëtarëve për KK.

U procedua me propozime për anëtarë të Komitetit për Komunitete.

U propozuan këta anëtarë:

1. **Qamile Qitaku**
2. **Tunë Dedaj**
3. **LDK – të dërgojë emrin e anëtarit deri në seancën e radhës.**

Kryesuesi vuri në miratim emrat e përfaqësuesve për anëtarë të KK.

Me vota unanime u miratua lista e anëtarëve për Komitetin për Komunitete.

U mor vendim që nga komunitetet të sjellën edhe 3 emra të tjerë.

**Driton Marku**, nga OSBE-ja, për të ndihmuar procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete, sqaroi procedurat e zgjedhjes dhe të delegimit të anëtarëve për Komitetin për Komunitete nga radhët e komuniteteve.

**Pika e gjashtë: Shqyrtimi i çështjes së dhënies së tokës komunale në shfrytëzim dhe ndërmarrja e veprimeve përkatëse ligjore (anulimi i vendimit të KK-nr. 01-11-464-585/11 e miratuar me dt. 29.07.2011, miratimi i vendimit për vlerësimin e ofertave dhe propozimi i listës së ngushtë KK për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim, nr. 01-464-1971/2011, i miratuar më dt. 24.06.2011, marrja e vendimit për publikimin e konkursit publik për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale).**

**Ali Shala**, foli dhe sqaroi çështjen në shqyrtim. Zyrtari Shala theksoi se kemi të bëjmë me një çështje tejet të rëndësishme juridike dhe ligjore, për të cilulën edhe nëse ka ingerenca të caktuara të subjekteve të ndryshme që të ngutet me këtë veprim unë mendoj për një punë shumë të rëndësishme për të cilën Asambleja komunale nuk guxon për t’u ngutur dhe nuk guxon që të

merr vendime jo në harmoni me ligjin. Sikurse e keni dëgjuar edhe ju në të gjitha mjetet e informimit shumica prej komunave të Kosovës në këtë drejtim kanë bërë shkelje të caktuara, edhe pasojat kanë lindur pas një kohe të caktuar, të cilat edhe mund të jenë të dëmshme edhe për Komunën, po ashtu edhe për Kuvendin. Prandaj, nuk kemi nevojë për të shpejtuar. Rendin e ditës unë me qëllim e kemi shqyrtuar me shërbimin e Kuvendit, me kryetarin dhe akterët të tjerë që të jetë shqyrtimi i dhënies së tokës komunale dhe ndërmarrja e veprimeve përkatëse ligjore. Kohë më parë kemi pasur marrë një vendim rreth përcaktimit të një lokacioni në zonën kadastrale të Dresnikut, mirëpo ai vendim yni ka pësuar me reagime dhe pakënaqësi nga komuniteti atje që jetojnë, edhe kemi qenë të detyruar që bashkë me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Drejtorinë e Kadastrit të shqyrtojmë mundësinë e gjetjes së një lokacioni tjetër të ri për caktimin e trojeve përkatëse dhe dhënien e tokës komunale në shfrytëzim për ata qytetarë. Sido që të jetë hapi fillestar që të merret këtu vendim për anulimin e vendimit të mëparshëm. Në kuadër të tërë kësaj Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Gjeodezisë kanë për obligim për ta hartuar regjistrin përkatës të pronave komunave të cilat në periudhat e ardhshme mund të jepen në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi. Atë regjistër nuk e kemi prandaj ne jemi të obliguar për të marrë vetëm këtë hapin e parë, përndryshe veprimet tjera na duhet për t'i marrë në mënyrë suksesive varësisht prej rrethanave që na krijohen. Në rend të ditës keni pasur edhe formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave. Të shkohet më bazë të një kërkesë që duhet për ta dhënë për rastin konkret MPB, akterët komunal duhet siguruar dokumentacionin për krejt këtë procedurë që kemi të bëjmë për të, prandaj nuk kemi nevojë për t'u ngutur. Vendimin e dytë nuk mund ta marrim, për faktin se kryetari i Komunës nuk e ka shpallur listën e ekzekutivit sepse pjesë përbërëse e atij komisioni duhet të jenë anëtarët e ekzekutivit, së bashku me subjektet tjera që janë të përcaktuara me ligj dhe një ekspert nga shoqëria civile. Prandaj, sot vetëm vendimin e parë mund ta marrim dhe do të jemi në rrjedhë të përbashkëta në procedurën e mëvonshme rreth kësaj çështjeje, kuptohet duke kompletuar dokumentacioni nga Drejtoria e Urbanizmit dhe nga Drejtoria e Gjeodezisë”, sqaroi zyrtari Shala.

**Haxhi Ibishi**, vuri në miratim vendimin për anulimin e vendimit të përparshëm.

**Me 20 vota për, 1 kundër u miratua propozimi për anulimin e vendimit të mëparshëm.**

**Sokol Bashota**, rikonfirmoi statusin e drejtorëve të drejtorive komunale, z. Ramiz Rusta dhe z. Rasim Millaku. Kryetari Bashota sqaroi se drejtorët, Rusta dhe Millaku janë anëtarë të Kuvendit të Komunës deri në zgjedhjen e drejtorëve të Ekzekutivit, ndërsa Prend Buzhala, ka statusin e shërbyesit civil, i cili duhet të vendos, përkatësisht të deklarohet nëse dëshiron të vazhdojë punën, ose të mbetet anëtar i Kuvendit, ngase sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nuk i lejohet mbajtja e dy pozitave”, sqaroi Kryetari.

**Prend Buzhala**, tha se për vetë faktin që nuk janë studiuar në mënyrë profesionale, dihet se biblioteka është organ profesional, e di që në komunat tjera, Mitrovicë, Gjilan e tjera bibliotekistët kanë qenë pjesëtarë të Asambleve komunale. “Këtu veprojnë ligje të tjera, atje të tjera, nuk po e kuptoj”, theksoi Buzhala.

**Ali Shala**, sqaroi çështjen e statusit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe theksoi se në aspektin juridik e ligjore, duke pasur parasysh dispozitat përkatëse, nenin 65 të LVL-së, pikën 65.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 2007/7 dhe nenin 2 të Udhëzimit 2010, del që parafolësi ka pengesa ligjore, se një anëtar i Kuvendit të Komunës nuk mundet për të qenë, përkatësisht edhe shërbyes civil, edhe anëtar i Kuvendit të Komunës. “Me sa di unë, me rastin

konkret, në konsultim të dosjes personale që kemi Zyra e personelit, parafolësi e ka në cilësinë e shërbyesit civil, prandaj ka pengesa ligjore. Duhet për t'u përcaktuar se cilin post, përkatësisht pozicion dëshiron ta mbajë. Për praktikat e komunave të tjera unë nuk kam njohuri, mirëpo unë e di ligjin që kemi para vetes dhe në bazë të të cilit duhet për të punuar. Prandaj, edhe rastet tjera, mirëpo mendoj që nuk ka, kështu që i përmenduri duhet për t'u përcaktuar para Asamblesë Komunale", sqaroi zyrtari Shala.

**Haxhi Ibishi**, falënderoi të gjithë grupet parlamentare për kontributin e dhënë.


Seancën e deklaroi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 14.40 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel Gojani



Kryetari i Kuvendit,  
Dr. Haxhi Ibishi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 51 paragrafi 2 dhe 51.paragrafi 3 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 30 dhe 35 të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe nenit 13 dhe 15 paragrafi 2t dhe 3 të Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, nenit 4, 5 dhe 11 deri 21 të Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-re të rregullt-të të radhës për vitin 2014, të mbajtur me \_\_\_\_\_, mori këtë:

Propozim:

## V E N D I M

Për

Themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Klinës  
( neni 51 pika 51.2 dhe 51.3 të LVL)

### I

Themelohën Komitete të tjera të Kuvendit të Komunës si trupa ndihmëse profesionale ku shumica e anëtarëve të komiteteve do të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës.

Këto komitete konsiderohet së janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësiave të tyre, kjo sipas specifikës komunale dhe drejtorive të themeluara duke respektuar përvojën përkatëse dhe kriteret profesionale.

Përbërja e komiteteve është 5 anëtarësh ndresa anëtarësia reflekton përbërjen e Kuvendit të Komunës, duke respektuar përfaqësimin gjinor dhe reflektimin e komuniteteve ekzistuese brenda komunës.

### II

Përbërja e Komiteteve si në pikën 1të këtij vendimi është:

I. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

II. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

- 1.
- 2.
- 3.

- 4.
- 5.

III. Komiteti për Planifikim Urban,Ekonomi dhe Zhvillim:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

IV. Komiteti për Shërbime Publike,

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

V. Komiteti për Pronë,

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

III

Komitetet si në pikën 1 të ketij Vendimi veprojnë konform dispozitave ligjore në fuqi-sipas LVL, Statutit të Komunës dhe Rregullorës për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës dhe Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm pas procedimit të rregullt ligjor konform nenit 81 të LVL.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr.  
Klinë më,

K r y e s u e s i,  
Dr.Haxhi Ibishi



Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 e duke pasur parasysh nevojën e domosdoshme për themelimin e komisionit që del nga dispozita e nenit 8 të Ligjit për Dhenjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës nr.04/L-144 dhe nenit 2 të Rregullorës QRKnr.23/2013 Për përcaktimin e procedurave të dhenies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i komunës së Klinës në seancën e \_\_\_\_\_ të rregullit të punës, të mbajtur më datën \_\_\_\_\_ 2014, mori këtë:

Propozim:

## V E N D I M

### I

THEMELOHËT Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhenien në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës në afatshkurter dhe afatgjatë.

### II

Komisioni përbëhet nga shtatë (7) anëtar, tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të propozuar nga Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshëm të përfaqsuera në Kuvend dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.

Përbërja e komisionit nga pika 1 e këtij vendimi caktohet siç vijon:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.
- 6.
- 7.

### III

Anëtarët e Komisionit më shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit.

IV-

Përgjegjësit e këtij komisioni rregullohen me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të komunës nr.04/L-144 dhe Rregulloren QRK nr.23/201për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtëshme të komunës.

V

Mandati i anëtarëve të komisionit përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të zgjatë me shumë se mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit.

VI

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dergimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. \_\_\_\_\_ 2014  
Më datë \_\_\_\_\_ 2014

Kryesuesi i Kuvendit  
Dr.Haxhi Ibishi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë  
Shërbimi për Punë të Kuvendit  
01Nr.06- /2014  
Klinë më, /2014

**PLANIFIKIMI I PUNËS SË KUVENDIT DHE KOMITETEVE  
DHE KALENDARI I TAKIMEVE PËR VITIN 2013**  
(sipas LVL, Statutit dhe Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve)

| Muaj  | Planifikimi i punëve të Kuvendit për vitin 2014<br>-Seancave të rregullta/ Solemne                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Punët e KK që parashtrohen para Kuvendit nga: Kryetari, anëtarët e Kuvendit, Drejtoritë, Komitetët, OJQ, qytetarët etj                                                                                                                                                                                                                   | K o m<br>Kom.Oblig.<br>Per çdo muaj<br>mbajnë<br>-1-séance<br>tërregulltë | i t e<br>Kom. Tjera<br>Per çdo muaj<br>mbajnë<br>-1-séance,<br>sipas nevojës | t ë t<br>Kom.Konsul.<br>Mbajnë se paku 4<br>seanca ne vit |
|-------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|
| Janar | I-Betimet e anëtarëve të Kuvendit (të rinj)<br><br>II-Zgjedhja e Kryesuesit Te Kuvendit<br><br>III-Themelimi i Komiteteve obligative<br>-Themelimi i KPF-a,<br>-Themelimi i KpK,<br><br>IV-Shfuqizimi i Vendimit të KK-nr.01-11-464-585/11 e dt.29.07.2011 për dhenje në shfrytëzim të 7 trojeve në fsh. Dresnik për 7 familje të komunitetit RAE(të zhvendosur) për | Shqyrtimi dhe miratimi i Proje.Rregulloreve komunale sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtuara<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për Debate me Pub. sipas nevojës. |                                                                           |                                                                              |                                                           |

|        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |  |  |  |
|--------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|        | ndertim tështëpive                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |  |  |  |
| Shkurt | <p>I-Betimet e anëtarëve të Kuvendit (të rinj),</p> <p>II- Njoftimi për emertimin e Drejtorëve të Komunës (nga Kryetarit i Komunës)</p> <p>III-Themelimi i Kom. të Tjera,</p> <p>IV- Themelimi i Komisionit të vlerësimit të ofertave për dhenien në shfrytëzim dhe kembimit të pronës së paluajtshme të komunës,</p> <p>V-Formimi i Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim,</p> <p>VI-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe Kalendarit të punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit.</p> <p>Seanca Solemne</p> <p>17.Shkurt 2014-</p> <p>Gjashtëvjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës</p> | <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Proje.Rregulloreve komunale sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,</p> <p>-Shqyrtimi i propozimeve për Debate me Pub. sipas nevojës.</p> |  |  |  |

|       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |  |  |  |
|-------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
| Mars  | <p>I--Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Prokurimit për vitin 2014 (sipas LVL,paraprakisht në KPF)</p> <p>II-Raporti ekonomiko-financiar për zbatimin e planeve investuese të komunës për gjashtëmujorin e I-të të vitit 2013 (raporton Kryetari i Komunës), që epet dy herë brenda vitit ,</p> <p>IV-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për tremujorin e fundit të vitit 2013 nga KPF ( ref.Drejtori i Financave, sipas Rregull. për perber. Dhe kompetenc.e komiteteve),</p> <p>V-Themelimi i Komiteteve Konsultative-këshilldhense-dhe marrja e Vendimit për shpallje të konkursit</p> <p>VI.Themelimi i Këshillave Komunale për sigurin në Bashkësi.</p> | <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Projek.Rregulloreve komunale sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,</p> <p>-Shqyrtimi i propozimeve për Debate me Pub. sipas nevojës.</p> |  |  |  |
| Prill | <p>I-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2013 (sipas LVL) duke përfshir</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF, sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe</p>                                                                                                                                                                                                                                                             |  |  |  |

|         |                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |  |  |  |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|         | <p>edhe raportin e punës së Prokurimit.</p> <p>II-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar tremujor për vitin 2014 nga KPF (ref.drejt.i Financave)</p> <p>III.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së KKSb.</p> | <p>miratimi i Projek.Rregulloreve komunale sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,</p> <p>-Shqyrtimi i propozimeve për Debate me Pub. sipas nevojës.</p>                                                                                    |  |  |  |
| Maj     | <p>I-Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2015-2017 (ref.Drejt.financ.),</p> <p>-Vizit zyrtare-pune jasht vendit për KK.</p>                                                                                              | <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF, sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Projek.Rregulloreve komunale sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga komitetet,</p> <p>-Shqyrtimi i propozimeve për Debate me Pub. sipas nevojës.</p> |  |  |  |
| Qershor | <p>I-Shqyrtimi dhe miratimi i Rishikimit të buxhetit për vitin 2014 (ref.drejt.financave),</p>                                                                                                                                | <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Projek.Rregulloreve komunale sipas nevojës,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara,</p> <p>-Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF,</p>                                                                                                                                                              |  |  |  |

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |  |  |  |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|         | Seanca Solemne<br>18 Qershor –Dita e<br>Çlirimit të Komunës së<br>Klinës                                                                                                                                                                                                                                                                              | sipas nevojës<br>-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i Raporteve<br>dhe Rekomandimeve<br>nga Komitetet e<br>Komunës sipas<br>paraqitjes,<br>-Shqyrtimi i<br>propozimit për<br>Debate me Pub. sipas<br>nevojës.                                                                                                                                                                                          |  |  |  |
| Korrik  | I-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i Raportit<br>financiar për<br>gjashtëmujorin e I-rë<br>të vitit 2014, nga KPF<br>(refer. Drejtori i<br>Financave),<br><br>II-Raporti mbi<br>situatën ekonomiko-<br>financiare të komunës<br>dhe zbatimin e<br>planeve investuese të<br>komunës për<br>gjashtëmujorin e I-rë<br>të vitit 2014 (nga<br>Kryetari i Komunës) | -Shqyrtimi dhe<br>miratimi i<br>Preferencave të KPF,<br>sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i<br>Projek.Rregulloreve<br>komunale sipas<br>nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i Propozim-<br>vendimeve të<br>parashtruara,<br>-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i Raporteve<br>dhe Rekomandimeve<br>nga Komitetet ,<br>-Shqyrtimi i<br>propozimit për<br>Debate me Pub. sipas<br>nevojës. |  |  |  |
| Gusht   | Muaji i pushimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | pushim                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |  |  |  |
| Shtator | I-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i Draft-<br>buxhetit të Komunës<br>për vitin 2015-<br>2017(ref. Drejt.financ)                                                                                                                                                                                                                                             | -Shqyrtimi dhe<br>miratimi i<br>Preferencave të KPF,<br>sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i<br>Projek.Rregulloreve<br>komunale sipas<br>nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe<br>miratimi i Propozim-<br>vendimeve të<br>parashtruara,                                                                                                                                                         |  |  |  |

|        |                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |  |  |  |
|--------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|        |                                                                                                                | -Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,<br>-Shqyrtimi i propozimit për Debate me Pub. sipas nevojës.                                                                                                                                                                                                            |  |  |  |
| Tetor  | I-Shqyr. dhe miratimi i Raportit financiar të komunës për nëntëmujorin e vitit 2014 nga KPF(ref.drej i financ) | -Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF, sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Projek.Rregulloreve komunale sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,<br>-Shqyrtimi i propozimit për Debate me Pub. sipas nevojës. |  |  |  |
| Nentor |                                                                                                                | -Shqy. dhe miratimi i Preferencave të KPF, sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Proj.Rregulloreve komunale sipas nevojës,<br>-Shqy. dhe miratimi i Propo-vendimeve të parashtruara,<br>-Shqyr. dhe mirat. i Raport. dhe Rekomandimeve nga komitetet,<br>-Shqyrtimi i propozimit për Debate me Pub. sipas nevojës.                      |  |  |  |

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |  |  |  |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
| Dhjetor | -Shqyrtimi dhe miratimi i Planifikimit të punës së Kuvendit dhe Komiteteve dhe përcaktimi i kalendarit për mbajtjen e seancave për vitin 2015,<br>-Raporti ekonomiko-financiar vjetor për zbatimin e planeve investuese të komunës për v. 2014, raport.Kryetari i Komunës (sipas LVL-dy herë në vit), | -Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF, sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Projek.Rregulloreve komunale sipas nevojës,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimeve të parashtruara,<br>-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporteve dhe Rekomandimeve nga Komitetet ,<br>-Shqyrtimi i propozimit për Debate me Pub. sipas nevojës. |  |  |  |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|

Pjesë integrale e këtij Planifikimi është edhe Kalendarit i punës së Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2014.

Kryesuesi,  
Dr.Haxhi Ibishi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 47 dhe 48 të Statutit të Komunës së Klinës dhe nenit 7 të Rregullores Komunale për punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të radhës për vitin 2014, të mbajtur më dt. \_\_\_\_\_ 2014, mori këtë:

Propozim:

## **V E N D I M**

**Për**

**Caktimin e Orarit vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete për vitin 2014**

### **I**

Miratohet Vendimi për caktimin e Orarit vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete për vitin 2014.

### **II**

Seancat e rregullta të Kuvendit të Komunës së Klinës do të mbahen javën e fundit të muajt, mundësisht ditën e premte javës.

Seancat e rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa do të mbahen 10 (dhjetë) ditë pune para seancave të Kuvendit të Komunës, ndërsa Komiteti për Komunitete 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para seancës së Kuvendit.

### **III**

Kuvendi i Komunës së Klinës mban së pakut 10 (dhjetë) seanca brenda vitit 2014, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

### **IV**

Mbledhjet plotësuese të Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete mund të mbahen në çdo kohë.

### **V**

Vendimi është i plotfuqishëm pas kalimit të procedurës ligjore sipas nenit 81 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS**

01Nr.  
Klinë, më

**K r y e s u e s i,**  
**Dr. Haxhi Ibishi**



KALENDAR I MBAJTJES SË MBLEDHJEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE TË KUVENDIT PËR VITIN- 2014

| Muajt   | KK    | K o m i t e t       |                     |                    |                    |                        | t j e r a           |                |                            |                               |
|---------|-------|---------------------|---------------------|--------------------|--------------------|------------------------|---------------------|----------------|----------------------------|-------------------------------|
|         |       | Kom. për Pol.Finan. | Kom. për Komunitete | Kom. për Shend.MS. | Kom. për Ars.K.R.S | Kom. për PU.E. dhe ZH. | Kom. për Sherb.Pub. | Kom. për Pronë | Kom. për Bujq.Zhv.Amb. MM. | Komit. për çështje emergjente |
| Janar   | 10    | -                   | -                   | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Shkurt  | 28/17 | 10                  | 7                   | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Mars    | 28    | 17                  | 12                  | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Prill   | 25    | 14                  | 9                   | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Maj     | 30    | 19                  | 12                  | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Qershor | 27/18 | 16                  | 12                  | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Korrik  | 25    | 14                  | 9                   | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Gusht   | /     | /                   | /                   | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Shtator | 26    | 15                  | 10                  | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Tetor   | 24    | 13                  | 8                   | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Nentor  | 27/28 | 17                  | 12                  | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |
| Dhjetor | 26    | 15                  | 10                  | -                  | -                  | -                      | -                   | -              | -                          | -                             |

Klinë më, \_\_\_\_\_, 2014.

Kryesuesi,  
Dr.Haxhi Ibishi



|                        |                                                                                         |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|
| Për/To/za :            | Komisionin për politikë e financa                                                       |
| Kopje :                | Asamblesë komunale - Klinë                                                              |
| Nga/From/Od :          | Drejtoria për Buxhet e Financa - z. Ramiz Rrusta                                        |
| Përmes/Through/Preko : | Z. Sokol Bashota – kryetar i KK- Klinë                                                  |
| Tema/Subject/Subjekat: | Kerkesë për vendim të bartjes së mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2013 |
| Data :                 | 07 .02.2014                                                                             |

Te nderuar

Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit nr. 03/L-048, neni 30, pika 30.1, 30.2. dhe Ligjit nr.04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, kërkojmë nga ju që mjetet e mbetura –të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2013 të rialokohen sipas kësaj kërkesë.

Mjetet që kanë mbetur nga fondi burimor 21 në kodet e kapitaleve janë :

| nr | programi | Kodi i projektit | Emertimi i projektit                     | Shuma e mbetur | vrejtje |
|----|----------|------------------|------------------------------------------|----------------|---------|
| 1  | 16018    | 84439            | Rreg.i oborrit të manastirit në Budisalc | 3,756.00       |         |
| 2  | 16018    | 85937            | Bashkfinancim me donatorë                | 141.56         |         |
| 3  | 16018    | 85941            | Mirëmbajtja dimrore e rrugëve            | 2321.74        |         |
| 4  | 16018    | 86484            | Fabrika për ujë të pijshëm               | 156,584.79     |         |
| 5  | 16018    | 88248            | Inventari për shtëpi të kulturës         | 1.04           |         |
| 6  | 16018    | 88250            | Ujsjellësi në Resnik                     | 4,317.00       |         |
| 7  | 16018    | 88251            | Kanalizimi në poterq të lartë            | 0.45           |         |
| 8  | 16018    | 88252            | Meremetimi i rrugës Sadik Rama           | 4.45           |         |
| 9  | 16018    | 88253            | Ndihmë për nevoja emergjente             | 19.91          |         |
| 10 | 16018    | 88254            | Ujsjellësi në Caravik                    | 12,221.98      |         |
|    |          |                  | Gjithsej :                               | 179,368.92     |         |

Këto mjete që kanë mbetur nga fondi burimor 21 në kodet e kapitaleve të alokohen për projektet kapitale si në tabelen në vijim :

| Nr. | programi | Kodi i projektit | Emertimi i projektit       | Shuma per alokim | Vrejtje |
|-----|----------|------------------|----------------------------|------------------|---------|
| 1   | 16018    | 85937            | Bashkfinancim me donatorë  | 4,677.35         |         |
| 2   | 16018    | 86484            | Fabrika për ujë të pijshëm | 166,259.20       |         |
| 3   | 16018    | 80941            | Plani urb. detal i qytetit | 8,432.37         |         |
|     |          |                  | Gjithsej :                 | 179,368.92       |         |

Mjetët që kan mbetur nga fondi burimor 22 në kodet e kapitaleve janë :

| nr | programi | Kodi i projektit | Emertimi i projektit        | Shuma e mbetur | Vrejtje |
|----|----------|------------------|-----------------------------|----------------|---------|
| 1  | 16018    | 80941            | Plani urb detal i qytetit   | 20,954.19      |         |
| 2  | 16018    | 85932            | Kanalizimi në fshatin Stupë | 593.44         |         |
| 3  | 16018    | 85937            | Bashkfinancim me donatorë   | 118.81         |         |
| 4  | 16018    | 86484            | Fabrika për ujë të pijshëm  | 3,240.80       |         |
|    |          |                  | Gjithsej :                  | 24,907.24      |         |

Këto mjete që kan mbetur nga fondi burimor 22 në kodin e kapitaleve të alokohen sipas tabelës në vijim :

| nr | programi | Kodi i projektit | Emertimi i projektit       | Shuma per alokim | Vrejtje |
|----|----------|------------------|----------------------------|------------------|---------|
| 1  | 16018    | 80941            | Plani urb. Detal i qytetit | 21,547.63        |         |
| 2  | 16018    | 85937            | Bashkfinancim me donatorë  | 118.81           |         |
| 3  | 16018    | 86484            | Fabrika për ujë të pijshëm | 3,240.80         |         |
|    |          |                  | Gjithsej :                 | 24,907.24        |         |

Mjetët që kan mbetur nga fondi burimor 21 në kodet e mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve janë si në tabelen në vijim :

| nr | programi | KODI | Emertimi i projektit | Shuma e mbetur | Vrejtje |
|----|----------|------|----------------------|----------------|---------|
| 1  | 16018    | 200  | Subvencione          | 1.70           |         |
| 2  | 16018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 7.26           |         |
| 3  | 16318    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 2,113.39       |         |
| 4  | 16635    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 166.23         |         |
| 5  | 17518    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 138.32         |         |
| 6  | 17518    | 132  | Komunali             | 46.80          |         |
| 7  | 18018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 3,021.71       |         |
| 8  | 19590    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 109.46         |         |
| 9  | 47018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 185.57         |         |
| 10 | 65090    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 188.36         |         |
| 11 | 66395    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 43.87          |         |
| 12 | 85018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 75.74          |         |
| 13 | 74050    | 111  | Paga dhe meditje     | 8,186.51       |         |
| 14 | 74050    | 130  | Mallra e sherbime    | 1.17           |         |
| 15 | 75585    | 130  | Mallra e sherbime    | 5.17           |         |
|    |          |      | Gjithsej :           | 14,291.26      |         |

Këto mjete që kan mbetur nga fondin burimor 21 në kodet e mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve të alokohen sipas tabelës në vijim :

| nr | programi | KODI | Emertimi i projektit | Shuma per alokim | vrejtje |
|----|----------|------|----------------------|------------------|---------|
| 1  | 16018    | 200  | Subvencione          | 1.70             |         |
| 2  | 16018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 7.26             |         |
| 3  | 16318    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 2,113.39         |         |
| 4  | 16635    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 166.23           |         |
| 5  | 17518    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 138.32           |         |
| 6  | 17518    | 132  | Komunali             | 46.80            |         |
| 7  | 18018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 3,021.71         |         |
| 8  | 19590    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 109.46           |         |
| 9  | 47018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 185.57           |         |
| 10 | 65090    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 188.36           |         |
| 11 | 66395    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 43.87            |         |
| 12 | 85018    | 130  | Mallra dhe sherbime  | 75.74            |         |
| 13 | 74050    | 111  | Paga dhe meditje     | 8,186.51         |         |
| 14 | 74050    | 130  | Mallra e sherbime    | 1.17             |         |
| 15 | 75585    | 130  | Mallra e sherbime    | 5.17             |         |
|    |          |      | Gjithsej :           | 14,291.26        |         |

Mjetet që kan mbetur nga fondi burimor 22 në kodet e mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve janë sipas tabelës në vijim :

| nr | programi | KODI | Emertimi i projektit | Shuma e mbetur | vrejtje |
|----|----------|------|----------------------|----------------|---------|
| 1  | 16018    | 200  | subvencione          | 44.21          |         |
| 2  | 16318    | 130  | Mallra e sherbime    | 33.89          |         |
| 3  | 17518    | 130  | Mallra e sherbime    | 9.55           |         |
| 4  | 17518    | 132  | komunali             | 45.49          |         |
| 5  | 65090    | 130  | Mallra e sherbime    | 66.59          |         |
| 6  | 66395    | 130  | Mallra e sherbime    | 118.01         |         |
| 7  | 85018    | 130  | Mallra e sherbime    | 51.74          |         |
|    |          |      | Gjithsej :           | 14,291.26      |         |

Këto mjete që kan mbetur nga fondi burimor 22 në kodet e mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve të alokohen sipas tabelës në vijim :

| nr | programi | KODI | Emertimi i projektit | Shuma per alokim |  |
|----|----------|------|----------------------|------------------|--|
| 1  | 16018    | 200  | subvencione          | 44.21            |  |
| 2  | 16318    | 130  | Mallra e sherbime    | 33.89            |  |
| 3  | 17518    | 130  | Mallra e sherbime    | 9.55             |  |
| 4  | 17518    | 132  | komunali             | 45.49            |  |
| 5  | 65090    | 130  | Mallra e sherbime    | 66.59            |  |
| 6  | 66395    | 130  | Mallra e sherbime    | 118.01           |  |
| 7  | 85018    | 130  | Mallra e sherbime    | 51.74            |  |
|    |          |      | Gjithsej :           | 14,291.26        |  |



Kuvendit të Komunës Klinë

01Nr. 06-805 /2014

Klinë, më 10.02.2014

PËR: KUVENDIN E KOMUNËS KLINË

NGA: KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA-Kryesuesi, Dr. Haxhi Ibishi



## P R E F E R E N C A T

E Komitetit për Politikë dhe Financa, të dt.10.02.2014 (seanca e I rë, 2014)

Komiteti për Politikë dhe Financa i KK, të Klinës, në seancën e I-rë të radhës për vitin 2014, ka shqyrtuar dhe preferuar për Kuvendin e Komunës së Klinës, lidhur me këto pika të rendit të ditës, duke shtuar dhe një pikë të rendit të ditës, në të ndryshme: **Propozimin për bartje të mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2013;**

I. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelin e komiteteve të tjera të Kuvendit,

II. Shqyrtimi i kompletimit të lëndës në lidhje me dhënien në shfrytëzim të tokës komunale-troje për komunitetin rom-ashkali dhe egjiptas (RAE),

III. Shqyrtimi i çështjes së hartimit të regjistrit të pronës komunale, e cila mund të jepet në shfrytëzim eventual:

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale (neni 2 i Rreg. QRK nr.23/2013) dhe,

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënie së pronës së paluajtshme në shfrytëzim (neni 3 i Rreg. QRK 23/2013),

IV. Shqyrtimi i Propozimit të Planit të Punës së Kuvendit dhe Kalendarit vjetor të punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit për vitin 2014,

**V. Shqyrtimi i kërkesave të arritura Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, fundi i vitit 2013-fillimi i vitit 2014,**

**VI. Në të Ndryshme, miratohet Propozimi për Shqyrtimin e kërkesës nga Drejtoria e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim , për bartje të mjeteve të pashpenzuara nga viti 2013 në vitin 2014 (riallokimi i mjeteve).**

Komiteti për Politikë dhe Financa, shqyrtoi të gjitha pikat e rendit të ditës dhe preferojë që të bartën në Kuvend për shqyrtim dhe vendosje me këto rekomandime:

## **I. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komiteteve të tjera të Kuvendit**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës u njoftua KPF-ja, për themelimin e këtyre Komiteteve që janë trupa ndihmës të Kuvendit , që ndihmojnë Kuvendin me kontributin e tyre në marrjen e vendimeve, pra me themelimin e pesë komiteteve të tjera:

1. Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
2. Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
3. Komitetin për Planifikim Urban , Ekonomi dhe Zhvillim,
4. Komitetin për Shërbime Publike, dhe
5. Komitetin Për pronë.

KPF-ja, rekomandon që Kuvendi i Komunës të themelojë këto Komitete të nevojshme për Kuvendin, ashtu siç parashihet edhe në propozim-vendim.

## **II. Shqyrtimi i kompletimit të lëndës në lidhje me dhënien në shfrytëzim të tokës komunale-troje për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas (RAE).**

Zyra komunale për komunitete dhe kthim, ka parashtruar kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për 16 familje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, të cilët për momentin janë të zhvendosur në Mal të Zi.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër ka përcaktuar një lokacion në fshatin Klinafç, në madhësi prej 050 h (50 ari).

Komiteti për Politikë dhe Financa konstaton se kjo çështje-për dhënie në shfrytëzim (afatshkurtër, apo afatgjatë ) të pronës komunale është çështje delikate, por edhe e rregulluar me Ligj nr.04/L-144 dhe Rregulloren e QRK nr.23/2013, andaj, sipas kërkesës në kuadër të këtyre familjeve hynë edhe 7 familje , të cilëve më parë iu janë ndarë trojet në fshatin Dresnik sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Klinës, ku tani është bërë shfuqizimi i këtij vendimi të mëparshëm i datës 29.07.2011.

Por, meqenëse lënda është aktualizuar me kërkesën e dt.27.12.2013, KPF-ja, në këtë seancë shqyrton kompletimin e lëndës dhe ndërmarrjen e veprimeve të mëtutjeshme procedurale për vendosje të kësaj çështjeje:

Kompletimi i lëndës së tillë është kërkuar edhe nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe atë përmes shkresës së dt.14.01.2014.

Në vazhden e kompletimit të dokumentacionit të lëndës, KPF-së i është dhënë në dispozicion :

- Certifikata pronësore për ngastrën 633,
- Lista e familjeve të komunitetit RAE,
- Kopja e Planit e dt. 10.12.2013,

- Shkresa e Kryeministrit të QRK e dt.06.04.2010,
- Vendimi i shfuqizimit nga KK, miratuar 10.01.2014, lidhur me shfuqizimin e Vendimit të dt.29.07.2011,
- Deklarata e komunitetit pritës të fshatit Klinafç e dt.08.01.2014,
- Shkresa e Qeverisë së Kosovës-Ministritë për Komunitete dhe Kthim e dt. 20.01.2014, që ka të bëjë me kërkesën që komunitetit RAE t'i ndahet tokë komunale për shfrytëzim.

KPF-ja, mendon se në bazë të shkresës së Qeverisë-Ministritë për Komunitete dhe Kthim, të dt.20.01.2014, lënda si e tillë duhet të trajtohet si rast i veçantë, në bazë të nenit 20 të Rreg. Nr.23/2013.

KPF-ja, konsideron se lëndës i mungon Regjistri i pronave komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim eventuale personave fizikë apo juridikë dhe se ai regjistër duhet të përmbajë specifikat dhe të dhënat tjera sipas nenit 7 të Ligjit nr.04/L-144 (Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës), në mënyrë që Kryetari i Komunës në rrjedhat e mëtejme procedurale të ketë regjistrin e tillë që përfshinë rastin konkret por edhe rastet e tjera. Po ashtu KPF-ja, preferon Kuvendit të Komunës formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe komisionin e ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

KPF-ja, konstaton se lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim duhet të qartësohet:

- afati i dhënies në shfrytëzim,
- kompensimi apo jokompensimi për shfrytëzim të pronës komunale,
- skica e parcelimit të trojeve përkatëse, sipërfaqja e tyre dhe të dhënat e tjera urbanistike, numri i saktë i trojeve, si dhe
- të sqarohet çështja e statusit të familjeve të zhvendosura se a kanë qenë të inkrimnuar apo jo dhe se a kanë qenë banorë të Komunës së Klinës, apo jo.

KPF-ja, kërkon që Zyra për Komunitete dhe Kthim së bashku me Kryetarin e Komunës të sqarohen për çështjen e afatit dhe kompensimit të shfrytëzimit, sepse kontratën e nënshkruan, në njërin anë Kryetari i Komunës, dhe në anën tjetër Institucioni Qendror (neni 20 paragrafi 8 i Rreg.23/2013).

### III. Shqyrtimi i çështjes së hartimit të regjistrit të pronës komunale, e cila mund të jepet në shfrytëzim eventuale

Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrtoi këtë pikë dhe rekomandon që regjistri të jetë i përgatitur për dhënie të pronave publike në shfrytëzim (neni 7 i ligjit nr.04/L-144), nga drejtoritë përkatëse, t'i jepet Kryetarit për parashtrim në Kuvendin e Komunës për miratim të një vendimi paraprak.

- Themelimi i Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale (neni 2 i Rreg.QRKnr.23/2013) dhe,
- Formimi i Komisionit për ankesa lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim (neni 3 i Rreg. QRK 23/2013).

Komiteti për Politikë dhe Financa, shqyrtoi këtë pikë lidhur me themelimin e këtyre dy komisioneve dhe preferoi që këto komisione të themelohen në seancën e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

### IV. Shqyrtimi i Propozimit për Planin e Punës së Kuvendit dhe Kalendarit vjetor të punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit për vitin 2014

Komiteti për Politikë dhe Financa, shqyrtoi pikën e sipërpërmendur dhe preferoi që Planin dhe Kalendarin e punës së Kuvendit për vitin 2014 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në seancën e ardhshme të KK.

## V. Shqyrtimi i kërkesave të arritura KPF dhe KK (fundi i vitit 2013-fillimi i vitit 2014)

1. Kërkesa e Ndërmarrjes tregtare SEMIRRA –Klinë, Sejdi Rraci, për lejimin e vazhdimin të punimeve në objektin afarist Semirra-të Ura e Drinit. Sipas kërkesës thuhet se punimet janë përfunduar P+1, e projekti ka qenë P+4, edhe pse kjo zonë është shpallur zonë ekonomike, siç thuhet në kërkesë se Komuna nuk ka kontribuar asgjë, edhe pse është me interes për zhvillim ekonomik (edhe pse në leje të ndërtimit i ceket kyçja me ujë, rrymë,kanalizim dhe trotuar). Kërkesës i bashkëngjitet një kopje e Planit P+4.

KPF-shqyrtoi kërkesën dhe preferoi që kjo kërkesë t'i adresohet Drejtorisë për Urbanizëm dhe MM, në mënyrë që të procedohet sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore.

2. Kërkesa e Muhamet Morinës, fsh.Gllarevë, për lejimin e shfrytëzimit të tokës pyjore me qira me kulturë pyll, me nr. të parcelës P-71010034-00001-2, Fleta poseduese, nr.18 ZK Gllarevë , në sipërfaqe prej 50 ari nga sipërfaqja e përgjithshme-3.09.25.ha, në afatin e caktuar nga Agjensioni Pyjor i Pyjeve (sipas kontratës me AKP, siç thuhet në kërkesë), pronë kjo P.SH. ORGANIZATA PU. SH. PR. OTAPB EKO. E.P.

Kërkesa bëhet për dhënie të pëlqimit se kjo ngastër nuk është rezervat apo diçka tjetër , që do të pengonte në ndërtimin e një objekti –stallë në dimension 15mx4m-60m2 për mbajtjen dhe kultivimin e dhive, për prodhimin e qumështit dhe mishit për treg.

Me dhënien e tokës në shfrytëzim me qira, pala ka për qëllim që të zbus papunësinë në familje dhe se nuk do të jetë barrë për shoqërinë.

(Kërkesa përmban edhe certifikatën e pronësisë dhe kopjen e planit të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronësi në Klinë, gjithashtu ka përsëritur kërkesën me ndryshim në sipërfaqe ku kërkon sipërfaqe prej 3 hektarësh për kullosa, ndërsa për ndërtim aq sa parashihet më lartë ).

Komiteti për Politikë dhe Financa, shqyrtoi kërkesën e sipërpërmendur dhe preferon që kërkesa të procedohet në nivele të tjera, nga se Kuvendi i Komunës nuk është titullar i pronës.

3. Kërkesa e Organizatës së Pensionistëve në Klinë, kryetari Prend Culaj, kërkon ndarjen e mjeteve buxhetore së paku në shumë prej 3000€ për vitin 2014 dhe kështu të vazhdohet për çdo vit kalendarik me funksionimin e kësaj organizate.

KPF-ja, shqyrton kërkesën, por në pamundësi buxhetore për të ndarë mjete në këtë fazë, kërkesa refuzohet.

4. Shkolla fillore e mesme e ulët –SHFMU “Azem Bejta”- paralelja e ndarë në Këpuz , Këshilli i prindërve- kryetari Islam Berisha, kërkojnë nga institucionet komunale që të na mbështesin financiarisht në transportin e nxënësve së paku 50%. Nxënësit udhëtojnë nga fshati Qeskovë, lagjet: Rastokë dhe Lumaj në gjatësi prej 4 km e më shumë.

Këta nxënës udhëtojnë për shkollë në mëngjesin e hershëm përmes rrugëve malore të rrezikuara nga qenët endacakë. Arsye tjetër është fakti se pjesa më e madhe e këtyre familjeve kanë kushte jo të mira ekonomike dhe se nuk kanë mundësi për të paguar udhëtimin.

Shpresojmë që kërkesa të merret në konsideratë në mënyrë që fëmijët tanë mos të shpëputen nga procesi mësimor. Kërkesës i bashkëngjiten edhe 7 anëtarët e tjerë të Këshillit të prindërve, ndërsa numri i nxënësve në këtë shkollë është 57.

KPF-ja, shqyrton kërkesën dhe sheh arsyen e kërkesës, por preferon që Drejtoria e Arsimit sa i përket kërkesave të kësaj natyre të respektoj Ligjin , në mënyrë që nxënësit të mos hasin në vështirësi për të përcjell procesin mësimor- për shkak të transportit.

5. Kërkesa e Sadik Elezaj, nga fshati Gjurgjevik i Vogël, për ndihmë financiare, për shkollim të lartë të djalit Drilon Elezaj- student i rregullt në Departamentin e Fizikës, në Universitetin e Prishtinës, në vitin e III-të, ka regjistruar semestrin e 5, ndërsa prindi në pamundësi për t'i ndihmuar më në shpenzime të regjistrimit të semestrave, ushqimit dhe pagesën e banimit detyrohet të paraqes kërkesë për ndihmë financiare. Sipas kërkesës kjo familje nuk gëzon kurrfarë të hyrash nga asnjë burim.

KPF-ja, shqyrtoi këtë kërkesë, që si rast duhet të kemi në konsideratë që të ndihmohet, por në koordinim të Drejtorisë së Arsimit dhe të Financave me Kryetarin.

6. Kërkesa e përfaqësuesit të lagjes Klinafç-Agim Hita, kërkon që t'i mundësohet kyçja e kanalizimit të ujërave të zeza me kanalizimin e qytetit. Kjo lagje numëron 80 banorë dhe, siç thuhet në kërkesë kjo ka hasur në kundërshtim me pronarin e Silosit, z.Tahiri, dhe së më të nuk ka hasur në mirëkuptim as ish- drejtori i Urbanizmi, z. Morina.

Në kërkojmë që në mes të pronarit të Silosit dhe Vendimit të nënshkruar nga ish- Kryesuesi i KK të has në mirëkuptim për kyçje me kanalizimin e qytetit.

KPF-ja, shqyrtoi kërkesën dhe preferon që pasi që çështja është e interesit publik, këtu pritët një mirëkuptim nga të gjitha palët.

7. Kërkesa e Hysen Ymerit, nga Klina-për të dytën herë paraqet kërkesë për dhënie të banesës apo ndarje të mjeteve për të blerë një banesë. ( Kjo kërkesë ka qenë edhe më herët për shqyrtim, por sipas dispozitave ligjore të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës të paluajtshme të Komunës, ku Kuvendi i Komunës nuk mund të jep pronën e Komunës në shfrytëzim afatgjatë 6 muaj para përfundimit të mandatit të rregullt ligjor), kërkesa i është pezulluar. Kërkesës i bashkëngjitet edhe dokumentacioni i nevojshëm.

KPF-ja, shqyrtoi kërkesën e Hysen Ymerit-mësimdhënës në Shkollën fillore "Ismet Rraci" dhe duke pasur parasysh kushtet e rënda ekonomike, preferon që kërkesa t'i drejtohet Drejtorisë së Urbanizmit në mënyrë që kërkesa e tillë të hyjë në kërkesat më me prioritet për strehimin e kësaj familje.

8. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Qendra për Punë Sociale, drejtori Elbasan Hoti-kërkon që t'i mundësohet një veturë për nevoja të Qendrës për Punë Sociale në Klinë. QPS, trajton 1000 familje me ndihmën sociale në qytet dhe në të gjitha fshatrat e Klinës, të cilat monitorohen 2 herë në vit nga komisionet e Qendrës, trajton edhe të moshuarit pa përkujdesje sociale, fëmijët më aftësi të kufizuara 1-18 vjet, gjithashtu me aktivitetet e përditshme me Departamentin e Mirëqenës Sociale në Prishtinë, me QPS-Pejë, Policinë e Kosovës etj, andaj kërkon një veturë.

KPF-ja, shqyrtoi kërkesën e sipërpërmendur, ku preferon që kërkesa e tillë të adresohet te Zyra e Kryetarit të Komunës.

9. Kërkesa e Lekë Dedaj, nga Klina-kërkon që t'i ndihmohet në mjete financiare në shumë prej 750€, për bërje të koronografisë, i cili para dy vitesh ka vënë edhe stenda në zemër, që vunë nga problemet kardiovaskulare, ndërsa jeton në kushte të vështira materiale dhe nuk është në marrëdhënie pune (edhe pse jurist i diplomuar që nga viti 2001).

KPF-ja, shqyrton kërkesën dhe preferon që kjo kërkesë të gjejë zgjidhje në Drejtorinë e Shëndetësisë.

VI. Të ndryshme, miratohet pëlqimi nga KPF-ja, që;

Kërkesa, Për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2013 në vitin 2014-të rialokohen mjetet, sipas kërkesës nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

KPF-ja, preferoi që kjo kërkesë -propozim , të kalojë në Kuvend për shqyrtim dhe vendosje.

Nga anëtarët e Komitetin për Politikë dhe Financa u propozuan dy kërkesa për seancën e radhës:

1 .Fadil Gashi anëtar i këtij Komiteti, kërkon që për seancën e radhës, Zyra e Prokurimit të sjell një raport për 6-mujorin e II-të të vitit 2013.

2. Po ashtu, edhe Avni Gashi, kërkon që në takimin e radhës të sillët një Raport detal për Fabrikën e ujit të pijes dhe kontratën përkatës.

Me respekt.

